

Prot 143

Data 30/01/2012

Prot 07

Data 01/02/12



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

**MIDIS**

**ORGANIT KOMBËTAR TË INVESTIGIMEVE  
TË INCIDENTEVE DHE AKSIDENTEVE  
AJRORE NË AVIACIONIN CIVIL**

**DHE**

**AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL**

**LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN NË RASTIN E  
INCIDENTEVE DHE/OSE AKSIDENTEVE  
NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL**

## **PËRMBAJTJA**

- 1. Fjalori**
- 2. Hyrje**
- 3. Terminologjia**
- 4. Qëllimi**
- 5. Mirëkuptim i ndërsjellë dhe bashkëpunimi në fushën teorike**
- 6. Principet bazë të MB**
- 7. Kontaktet**

## 1. Fjalori (shpjeguesi i termave të përdurura)

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AC	Aviacioni Civil
ANTA	Agjensia Nacionale e Trafikut Ajror
IND	Inspektori Në Detyrë
MB	Memorandum Bashkëpunimi
RSh	Republika e Shqipërisë
TIA	Tirana International airport
CVR	Cockpit Voice Recorder
FDR	Flight Data Recording
OKIIA	Organi Kombëtar i Investigimit të Incidenteve/Aksidenteve
A/C	Aircraft (avion)

## 2. Hyrje

- 2.1 Ky Memorandum Bashkëpunimi shpreh mirëkuptimin e OKIIA dhe AAC, të cilave më pas do ti referohemi si Palët në këtë MB, për bashkëpunimin dhe asistencën në rastin e një incidenti/aksidenti të rëndë në fushën e AC. Palët i përgjigjen ligjeve të RSh-së dhe për këtë arsye ata janë të lidhur nga standardet e përfshira në këtë legjislacion. Konkretisht, në çdo rast, palët veprojnë në zbatim të:
- Ligji Nr. 10040, datë 22.12.2008 "Për Kodin Ajror të RSH-së", i ndryshuar.
  - Ligji Nr. 10233, datë 11.02.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", i ndryshuar.
  - Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 2.6.2010 "Për krijimin e Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil".

- 2.2 Ky MB përcakton masat procedurale për bashkëpunim dhe asistencës midis Palëve në përputhje me legjislacionin e RSh.

## 3. Terminologjia

- 3.1 Fjalët dhe frazat e përdorura në këtë dokument, kanë të njëjtin kuptim ashtu si përshkruhet në legjislacionin e RSh.

## 4. Qëllimi

- 4.1 Memorandumi i Bashkëpunimit (më poshtë do të shkruhet MB) ka si qëllim që, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, dhënies dhe marrjes së dokumentave të regjistrimit të incidenteve /Aksidenteve, mbështetjen e palëve me specialistë e expertë, të kryehet një investigim sa më objektiv në nxjerrjen e shkaqeve të aksidentit/incidentit të ndodhur.
- 4.2 MB angazhon palët në përgatitjen dhe zbatimin e rekomandimeve të cilat u jepen operatorëve për parandalimin e aksidenteve/ incidenteve në të ardhmen.
- 4.3 MB synon rritjen e efikasitetit në kryerjen e detyrës e të dy Palëve, në rast të një incidenti/aksidenti të rëndë për:
- përmirësimin e sigurimit të navigimit ajror, kryerjen e shpejtë të investigimeve, për të parandaluar aksidente/incidente në të ardhmen.

- b) për konsolidimin dhe bashkëpunimin, për t'i bërë palët sa më afta për të kryer misionet e tyre.
- 4.4 OKIIA dhe AAC pranojnë se ky MB nuk kufizon diskrecionin dhe kompetencat e secilës palë bazuar në legjislacion.
- 4.5 Inspektorët e OKIIA kryejnë investigime teknike në fushën e AC. Qëllimi i çdo investigatori të OKIIA është parandalimi i aksidenteve në të ardhmen, nëpërmjet konstatimit të shkaqeve dhe rrethanave të aksidentit. Investigimi nuk do të ketë për qëllim përcaktimin e besueshmërisë apo të fajit.

## 5. Mirëkuptim i ndërsjellë dhe bashkëpunimi në fushën teorike

- 5.1 Secila palë pranon rolin e rëndësishëm të palës tjetër në lidhje me interesin publik dhe nevojën e kryerjes së detyrës sa më mirë dhe brenda një kohe sa më të shpejtë, dhe në bazë të detyrimeve të tyre ligjore.
- 5.2 Palët sigurojnë pjesëmarrje reciproke në seminare dhe takime të organizuara në funksion të Sigurisë së Fluturimeve në Hapsirën Ajrore të Republikës Shqiptarisë, përfshirë dhe çështje të fushës së investigimit të aksidenteve dhe incidenteve.
- 5.3 AAC siguron pjesëmarrjen e përfaqësuesve të OKIIA në analiza të ndryshme që organizojnë Drejtoritë e Sigurisë Ajrore, Sigurisë së Aeroporteve dhe Trafikut Ajror për probleme të sigurisë së Aviacionit.
- 5.4 Palët marrin përsipër të organizojnë takime për konsultime në rang specialistesh dhe ekspertësh për të diskutuar në përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit të sigurisë.
- 5.5 Palët sigurojnë që do të ndërmarrin hapa të arsyeshëm që i gjithë stafi i tyre të familiarizohet me termat dhe kushtet e këtij MB.

## 6. Hyrja në fuqi, kohezgjatja dhe përfundimi i afatit të memorandumit

- 6.1 Ky memorandum hartohet në 2 (dy) kopje. Palët mund ta ndryshojnë këtë MB në çdo moment duke rënë dakort midis tyre. Çdo ndryshim duhet të bëhet me shkrim dhe do të jetë një shojcë e këtij MB dhe hyn në fuqi në datën që bihet dakort në shtojcë.
- 6.2 Ky MB hyn në fuqi menjëherë në datën që nënshkruhet nga të dy palët, dhe ka vlefshmëri 2 (dy) vjet. Në mbarim të këtij afati, mund të rishikohet dhe/ose të riaprovohet një afat i ri vlefshmërie.
- 6.3 Secila palë në çdo moment mund të shprehë me njoftim me shkrim qëllimin e saj për prishjen e këtij MB. MB do të përfundojë në datën e caktuar në njoftim.

## 7. Kontaktet

### 7.1 Kontaktet për OKIIA:

Adresa: Rruga Pashko Vasa, P.13/6, Tiranë, Shqipëri, P.O.Box74

Tel: +355 4 2244472 | Fax: +355 4 2244473

Mobile: +355 696060022

E-mail: [info@okiia.gov.al](mailto:info@okiia.gov.al)

### 7.2 Kontaktet për AAC:

Adresa: Rruga Muhamet Gjollësja, pranë parkut të delegacioneve, Tirane.

Tel: +355 4 2251220 | Fax: +355 4 2223969

Drejtor i Përgjithshëm i OKIIA

**Dipl.Ing. Arben XHIKU**



The stamp is circular and contains the following text: "REPUBLIKA E SHqipërisë" at the top, "Organizata Kombëtare e Sigurimit të Aksioneve dhe të Aviacionit Civil" around the perimeter, "Incidenteve Aërore në Aviacionin Civil" in the center, and "TIRANË" at the bottom. A small emblem is visible in the center of the stamp.

Drejtor Ekzekutiv i AAC

**Ervin MAZNIKU**



The stamp is circular and contains the following text: "REPUBLIKA E SHqipërisë" at the top, "Ministria e Transportit dhe Infrastruktura" around the perimeter, "Komiteti i Aviacionit Civil" in the center, and "TIRANË" at the bottom. A small emblem is visible in the center of the stamp.